

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PER

TRAJTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MJETEVE RRUGORE, LUNDRUESE, TË KONFISKUARA, SI PASOJË E SEKUESTRIMIT, NDALIMIT ADMINISTRATIV, NGA POLICIA E SHTETIT DHE MJETEVE TË TJERA”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji është hartuar me qëllim rregullimin e procedurave të trajtimit dhe administrimit të mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera. Për hartimin e këtij projektligji u ngrit Grupi i Punës, me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr.21 prot., datë 19.01.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga policia e shtetit dhe mjeteve të tjera, deri në datën 31.12.2022”, me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe në takimet për diskutimin e problematikave dhe propozimet për zgjidhjen e tyre, u ftuan përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme. Qëllimi i hartimit dhe miratimit të këtij projektligji vjen si pasojë e nevojës për gjetjen e një mekanizmi, i cili do të mundësojë zgjidhje efektive për problematikën e krijuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ku aktualisht ndodhen 16.445 mjete, me statuse të ndryshme, që kanë krijuar mbarjtje dhe një problematikë të vazhdueshme, e për të cilat ka pasur zgjidhje për të kryer procedurat e mëtejshme, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Me anë të këtij projektligji do të zgjidhen disa probleme emergjente, si:

- a) mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit apo ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”;
- b) mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me lejet përkatëse të qarkullimit/lundrimit nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit;
- c) mjetet rrugore dhe lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare (me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi/lundrimi nga një shtet i huaj) dhe që janë të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit apo ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit;
- ç) mjetet e braktisura, të cilat janë identifikuar si objekt i kryerjes së veprës penale, por autori i veprës penale nuk njihet apo nuk është gjetur dhe nuk kanë dokumentacion, mjete që janë ndaluar administrativisht për mangësi në dokumentacion, mjete të braktisura për të cilat nuk është shfaqur interes t’i tërhequr apo mjete të debitorëve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike, por vjen si një domosdoshmëri për rregullimin e një situate me rrezik të madh potencial, që mbajnë këto mjete, për mjedisin dhe sigurinë publike, pasi në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, si zjarre apo shkarkime elektrike, dëmet do të jenë të mëdha prej karburantit dhe lubrifikantëve që kanë këto mjete rrugore apo lundruese. Ky projektligj është në përputhje me objektin dhe fushën e veprimtarisë së strukturës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Gjithashtu, ky projektligj vjen si domosdoshmëri për shmangien në vijim të dëmit ekonomik dhe konflikteve të krijuara me pronarët e pikave të ndalimit administrativ të mjeteve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe në pikat e ndalimit administrativ të mjeteve rrugore, aktualisht ndodhen **16.445 mjete**, me statuse të ndryshme, një pjesë e të cilave, ka vite që nuk po ju jepet një zgjidhje për të kryer procedurat e mëtejshme.

Nga totali mjeteve rrugore janë:

- a. prova materiale 8.440 mjete rrugore,
- b. mjete të ndaluara administrativisht për shkelje të rregullave, të braktisura apo debitorë 8.005 mjete, ku nga këto 2.419 mjete rrugore, janë të pajisura me dokumentacionin përkatës për të kaluar në Rezervat Materiale të Shtetit, por që nuk janë tërhequr,
- c. janë dhe funksionojnë 64 pika bllokimi në ambientet policore dhe të tjera të marra me qira, për të cilat Policia e Shtetit paguan kosto të larta dhe të panevojshme financiare,
- ç. janë angazhuar në këto pika 98 punonjës policie, të cilët janë hequr nga shërbimet policore.

Deri në datën 30.12.2012, për mjetet gjendje, në mjediset e Komisariateve të Policisë apo në pikat e bllokimit, për të cilat nuk ka pasur probleme në ndjekje, në hetim ose verifikime të ndryshme, është vepruar në bazë të ligjit nr.130/2012 “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga policia e shtetit deri në datën 30.12.2010” dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 313, datë 12.07.2013, i Ministrisë Brendshme, Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punëve Publike e Transportit “Për procedurat e kalimit dhe çregjistrimit të mjeteve nga mjediset e Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse dhe ato të Policisë Kufitare dhe Migracionit”, i cili përcakton procedurat e kalimit dhe të çregjistrimit të mjeteve rrugore dhe lundruese, të ndaluara ose të bllokuara nga Policia e Shtetit që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit, mënyrën e administrimit e përdorimit e të ardhurave që gjenerohen nga ky proces, si dhe procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese për kundërvajtjet në fushën e qarkullimit rrugor.

Për kryerjen e veprimeve është aplikuar procedura e miratuar në Udhëzimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 687, datë 05.12.2013, “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që

ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar. Në pikën 23, përcaktohet se: “Në marrëveshje mes palëve, ku dorëzimi “*de jure*” mund të bëhet edhe direkt në pikat ekzistuese të ruajtjes së mjeteve në përputhje me dokumentacionin e dosjes së secilit mjet dhe mjetet do të vijojnë të ruhen pranë këtyre të fundit, deri në përfundimin e procedurave të tjetërsimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.”

Në vitin 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit kaloi në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe procesi i rregulluar me aktet e mësipërme u ndërpre deri në daljen e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë së Mbrojtjes nr.9714/3, datë 01.01.2019 “Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e Drejtorive Vendore të Policisë së Shtetit dhe ato të Policisë Kufitare dhe Migracionit, të Drejtoritë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit”.

Zbatimi i këtij udhëzimi i ka dhënë zgjidhje problematikës së një pjesë të mjeteve, të cilat kanë qenë me dosje dhe dokumentacion dhe procedura të rregullta, ndërkohë që vazhdon të jetë problem “kategoria e mjeteve pa dokumentacion të plotë, të braktisura, etj.”, ndër vite vazhdojnë të qëndrojnë në ambientet e pikave të bllokimit, të strukturave të Drejtorive Vendore të Policisë. Ky projektligj synon të rregullojë problematikën, duke parashikuar sigurimin e informacionit dhe bashkëpunimin me Prokuroritë, për mjetet pa dokumentacion shoqëruar, që të identifikohet statusi juridik e më pas të veprohet nga institucionet përkatëse. Gjithashtu, problematika ka pasur edhe referuar mjeteve të cilat kanë status juridik të qartë, të cilat Rezervat Materiale të Shtetit duhet t’i administrojnë në zbatim të nenit 209 të Kodit Rrugor, megjithatë, për shkak të pamundësisë në kapacitete, veçanërisht burime njerëzore, nuk ka pasur zgjidhje dhe mjetet kanë mbetur stok në ambientet e komisariateve të policisë.

Mjetet rrugore të ndaluara administrativisht që ndodhen në strukturat vendore të Policisë dhe Pikat e Ndalimit Administrativ, deri në datën 10 Qershor 2020

Nr.	Struktura Policore	Mjete/ Totali	Provë materiale	Administrative /braktisur /debitorë	Pika bllokimi	Punonjës të angazhuar	Mjete me dosj per rezervat
1	DVP LEZHË	1440	1259	181	4	5	169
2	DVP KORÇË	142	104	38	2	4	26

Relacion shpjegues për projektligjin “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ, nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera”

3	DVP DIBER	351	233	118	3	12	118
4	DVP VLORË	2562	331	2231	5	5	342
5	DVP ELBASAN	1119	211	908	7	5	216
6	DVP TIRANË	3594	2440	1154	4	14	704
7	DVP KUKËS	210	56	154	3	4	72
8	DVP SHKODËR	952	125	827	8	4	36
9	DVP FIER	1992	1834	158	10	4	141
10	DVP BERAT	739	233	506	3	13	40
11	DVP DURRËS	1853	1162	691	5	9	483
12	DVP GJIROKASTËR	649	298	351	4	5	19
13	KOM. KAVAJË	496	17	479	1	5	26
14	KOM SARANDË	346	137	209	5	9	27
	TOTALI	16525	8440	8005	64	98	2419

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me legjislacionin kombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektligjin “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ, nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera”

Projektligji permban 13 nene dhe pesë Krerë.

Kreu I përmban dy nene, 1 dhe 2, që parashikojnë qëllimin dhe objektin e këtij projektligji, për rregullimin e procedurave të trajtimit, administrimit dhe nxjerrjes në ankand publik të mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit, si dhe mjeteve të tjera.

Kreu II ka në përmbajtje 2 nene, 3 dhe 4, të cilat parashikojnë se mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi dhe mjetet rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi, të cilat nuk kanë statusin “provë materiale”, kalojnë për procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

Kreu III, ka në përmbajtje 2 nene, 5 dhe 6, të cilat parashikojnë se mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe Mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara, të cilat nuk kanë statusin “provë materiale”, kalojnë për procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

Kreu IV, ka në përmbajtje nenin 7, i cili parashikon se Mjetet që janë ndaluar administrativisht për mangësi në dokumentacion, mjetet e braktisura apo mjetet e debitorëve, për të cilat poseduesit e tyre nuk shfaqin interes për kthimin brenda 90 ditëve nga ndalimi administrativ, kalojnë për administrim dhe procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

Në Kreun V parashikohen dispozita kalimtare, konkretisht se se Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, për mjetet rrugore ose lundruese dhe mjetet e tjera me status të panjohur, por në cilësinë e provës materiale që gjenden në mjediset e Drejtorive Vendore të Policisë dhe Drejtorive Vendore të Policisë së Kufirit dhe Migracionit, brenda afatit 6 (gjashtë) muor nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë statusin juridik të tyre dhe kalojnë për administrim nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për ndjekjen e procedurave të mëtejshme, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie. Gjithashtu, parashikohet se kalimi i këtyre mjeteve nga mjediset e Drejtorive Vendore të Policisë dhe Drejtorive Vendore të Policisë së Kufirit dhe

Relacion shpjegues për projektligjin “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ, nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera”

Migracionit, së bashku me dokumentacionin shoqërues të mjetit, bëhet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji pranë mjediseve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie ose nxirren në ankand publik nga Policia e Shtetit. Procedurat e kalimit dhe të regjistrimit rregullohen me Udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave.

Të ardhurat e gjeneruara, sipas këtij projektligji do të kalojnë në favor të buxhetit të Policisë së Shtetit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ku një pjesë e këtyre të ardhurave do të përdoren për transferimin e këtyre mjeteve nga mjediset e pikave të bllokimit në ambientet e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Per zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk shoqërohet me efekte financiare për Buxhetin e Shtetit, por do të sjellë të ardhura të konsiderueshme nga shitja e këtyre mjeteve.

PROPOZUESI

MINISTRI

TAULANT BALLA